



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A nr.722/2021

PROCESVERBAL I KOLEGJIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

I përpiluar me datë 10.10.2022, në seancën për këshillim dhe votim, të Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2310/2021 të datës 07.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.722/2021 të datës 06.08.2021 të parashtruar ankuesit

adresë rruga të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat me
në Prishtinë, kundër organit të punësimit/ Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike "kompensim material".

Të pranishëm në seancë ishin:

Anëtarët e Kolegjit për shqyrtimin e ankesave: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë.

Procesmbajtëse: Zyle Millaku-Gojnovci/Bashkëpunëtoresh profesionale.

Rasti i lëndës : me nr. protokollit 4111/2021 me numër A.nr.722/2021 e datës 06.08.2021.

Sipas: Aktgjykimit A.nr.2310/2021 të datës 09.09.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-

Departamenti për Çështje Administrative

Ankuesja: -grup ankuesish

Organi i punësimit, MASHIT,

Objekti i lëndës: " "kompensim material".

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim, më datë 27.05.2021 kanë parashtruar kërkesë tek Ministria dhe Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit përmes të cilës kanë kërkuar që të kompensohen në vlerën e dy (2) euro në emër të shujtës ditorë sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive nga data 01.01.2015 deri më datë 31.12.2018. Meqë nuk kanë marr përgjigje më datë 21.07.2021 përfaqësuesi i ankuesve ka parashtruar kërkesë për qasjen në aktin administrativ të miratuar në heshtje duke kërkuar kompensimin e shujtës prej datës 01.01.2015 deri më datë 31.12.2021, ndërsa Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 27.07.2021 i përgjigjet përfaqësuesit të ankuesve duke e njoftuar që kërkesa është e porealizueshme.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre më datë 05.08.2021, kanë parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më datë 06.08.2021 nën shenjë A.nr.722/2921, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës së përgjithshme administrative, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.08.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Më datë 09.09.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokolli 4768/2021 të datës 24.09.2021 ka njoftuar përfaqësuesin e ankuesve lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtën lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 07.09.2022 sipas Aktgjykimit A. nr.2310/2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve në këtë rast ankuesve duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 24.09.2021 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesve me A.nr.722/2021 të datës 06.08.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:4111/2021 e datës 06.08.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aneksin e kërkesës e parashtruar nga ankuesit me datë 12.07.2021 tek Ministria dhe Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Kërkesën që të na lejoni qasje në aktin administrativ e datës 21.07.2021 nga ankuesit; Kërkesën për njohje të drejtës për kompensim të shpenzimeve për ushqim e datës 27.05.2021 nga ankuesit, Përgjigjen në ankesë e datës 27.07.2021; Autorizimin e ankuesve për përfaqësuesin e tyre; Vërtetimin e marrëdhënies së punës me Nr. Ref: 4/4-33 i datë 24.05.2021 për ankuesit; Kërkesën për Përgjigje në ankesë e datës 10.08.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 09.09.2021; Akt Emërimet e ankuesve; Njoftimin e datës 24.09.2021 për përfaqësuesin e

ankuesve; Aktgjykimit A.nr.2310/2021 të datës 07.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të , ka konstatuar se ankesa e ankuesve si në pikën e I të dispozitivit të këtij vendimi, është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit ka gjetur që ankuesit si në pikën I të dispozitivit si: i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 12.09.2021 në pozitën "Administrator i Teknologjisë Informativë", Minire Gashi e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Zyrtare për Buxhet", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Zyrtare e Arsimit Parashkollor", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 në pozitë "Koordinatore e Shkollave Promovuese të Shëndetit", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 në pozitën "Zyrtare në Njësinë e Arsimit Special" e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në pozitën "Zyrtare në Departamentin e Prokurimit", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 05.12.2021 në pozitën "Zyrtare e Lartë e Prokurimit", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 17.04.2012 në pozitën "Asistente Administrative", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në pozitën "Zyrtare në Njësisë për Aftësim pa Shkëputje nga Puna", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në pozitën "Zyrtare për Rekrutimin e Personelit", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 27.12.2011 në pozitën "Zyrtare e Personelit", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në pozitën "Zyrtar i Arsimit të mesëm të Ulët", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 27.04.2016 në pozitën "Zyrtar i Lartë për Shkencë", i punësuar sipas Akt Emërimit 05.01.2017 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Planprograme dhe Tekste Shkollore", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.06.2017 në pozitën "ZYRTAR I Lartë për Arsim Provat Parauniversitar", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 18.05.2012 në pozitën "Zyrtare për Statistika", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 29.09.2011 në pozitën "Përkthyes i Gjuhës Angleze", Morina e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 12.04.2012 në pozitën "Lektore", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.03.2012 në pozitën "Zyrtare për Kontabilitet", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 26.07.2013 në pozitën "Asistente Ekzekutive në Zyrën e Sekretarit", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Zyrtar për Aftësimin e Mësimdhënësve", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 25.10.2021 në pozitën "Zyrtare për Arsim Parashkollor", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 02.09.2016 në pozitën "Zyrtar i Lartë për Njohje dhe Barasvlerë të Diplomave dhe Dokumenteve Parauniversitare", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.02.2012 në pozitën "Zyrtare për Standarde dhe Vlerësim për Komunitetin Turk dhe Boshnjak", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Zyrtar për Standarde dhe Vlerësim" e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Zyrtare për Standarde dhe Vlerësim për Shkencat Natyrore", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 20.04.2012 në pozitën "Zyrtare për Standarde dhe Vlerësim për Gjuhën Shqipe" e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 në pozitën "Zyrtare për Standarde dhe Vlerësim për Shkencat Shoqërore", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 02.04.2012 në pozitën "Zyrtar për Vlerësim" i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 15.05.2012 në

pozitën " Zyrta r për Inspektimin e Projekteve", Arian Mustafa i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 26.07.2013 më pozitën " Zyrta r i Arsimit të Mesëm të Lartë" e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Ndihmëse Arkiviste" i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në pozitën "Zyrta r i menaxhimit të pasurisë" i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 08.12.2011 në pozitën " Zyrta r i Lartë i Prokurimit" e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 12.04.2012 në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit të Personelit", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 02.04.2012 në pozitën "Zyrtare për Emërimit të datës 24.10.2011 në pozitën "Drejtor i Departamentit të Prokurimit", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Zyrtare për Zotime", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Zyrta r gjuhësor (përkthyes) shqip-serbisht", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në pozitën "Zyrtare për Vlerësim", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 në pozitën "Zyrtare e Arsimit të Mesëm të Lartë", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 10.05.2012 në pozitën "Zyrtare për Zotime", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Auditore", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 29.11.2013 në pozitën "Drejtor i Njëjesisë së Auditimit të Brendshëm", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.03.2017 në pozitën "Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme" i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në pozitën "Zyrta r për Buxhet", të gjithë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë që autoriteti punëdhënës të bëjë kompensimin në vlerën e dy (2) euro në emër të shujtës ditorë sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive nga data 01.01.2015 deri më datë 31.12.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilin janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 38/2014 më datë 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vite, siç përcaktohet: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*", respektivisht deri më datë 31.12.2017. Mirëpo Oda Ekonomike e Kosovës si partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social dhe njëherit nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e kësaj marrëveshje pas datës 31.12.2017.

Bazuar në konstatimin e lartcekur dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa e ankuesve si në pikën e parë (I) të dispozitivit të këtij vendimi për realizimin e kompensimit të ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punës është parashkruar, kështu që pretendimi i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin të Kosovës, është jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve si në pikën e II të dispozitivit të këtij vendimi, *sepse*:

Ankuesit e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Receptioniste", e punësuar sipas Akt Emërimit të jo karrieres së datës 01.10.2011 në pozitën "Asistente Teknike", e punësuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 20.06.2012 në pozitën "Teknike për Inventar dhe Mirëmbajtje", i punësuar sipas Akt Emërimit 07.05.2012 në pozitën "Asistent i Transportit (vizitës)", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.07.2016 në pozitën "Receptioniste", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Receptioniste", e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.07.2017 në pozitën "Receptioniste", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Ndihmës në njësinë e pranim-dorëzimit", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 08.05.2012 në pozitën "Asistent i Transportit", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.04.2012 në pozitën "Asistent i Transportit", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2012 në pozitën "Punëtor i Sigurimit", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Punëtor i Sigurimit", e punësuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 20.06.2012 në pozitën "Zyrtare për Furnizim", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 02.04.2012 në pozitën "Asistent i Transportit", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 02.04.2012 në pozitën "Asistent i Transportit", i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në pozitën "Punëtor i Sigurimit" dhe i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 11.05.2012 në pozitën "Asistent i Transportit" të gjithë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se këto pozita në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht nenit 2 paragrafi 2.4 hyjnë në kategorinë e nëpunësve administrative teknik dhe mbështetës ku përcaktohet se *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike* dhe si rrjedhojë ankuesit si në pikën II të dispozitivit nuk kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi.

Duke u bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtaret publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe të gjitha shkresave të bashkëngjitura lëndës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vendosi në mënyrë unanime të marr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.722/2021 e datës 06.08.2021 e ankuesve:

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.722/2021 e datës 06.08.2021 të ankuesve

Malsore Gashi BAJRAKTARI, Kryetare

Arben MEHMETI, Anëtar,

Ardita Haxhnikaj DEMI Anëtare

Zyle Millaku GOJNOVCI, Procesmbajtëse